



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
"Procedura e Prokurimit për Organizimin e Ceremonisë së Mbylljes së Ekipeve Sportive për vitin 2023-2024".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 01.03.2024 - 30.06.2024 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Procedure Prokurimi per Sherbime Multifunkionale te Organizimit dhe Menaxhimit te Eventeve Sportive	Realizim eventesh te ngjarjeve sportive ku te ofroje sherbimet dhe materialet si: -Projektor, Led Wall, Foni, Dj - Transport -Ushqimi/Catering -Akomodim -Fotografi -Animatore - Flamuj te ndryshem, banera -Kamera, transmetim live - Tollumbace - Adezive	Numer sherbimesh	Sherbime	10.000.000 leke	10.000.000 leke	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	1 dite – Data 1 Qershor sipas kalendarit te miratuar nga Ekipet Sportive do te behet ceremonia e mbylljes se vitit 2023-2024

4. Metodologjia dhe plani i punës

Do të kontaktohet indiv/ekip/kompani i cili do të propozojë ofertën me të mirë për kryerjen e organizimit eventesh sportive.

5. Kualifikimet e nevojshme

Kualifikimet:

- Të ketë të paktën 4 vjet eksperience në fushën e shërbimeve të kërkuara.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme për organizimin e eventeve të ngjashme kulturore dhe sportive.
- Të ketë infrastrukturen e nevojshme për organizimin e eventeve të ngjarjeve sportive.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare për event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresën e saktë.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 27.05.2024 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.